Inclusion of Roma and Migrants in Schools

Newsletter

Numër 5 • Nëntor 2018

Takimi i5-të i projektit,Shkup, IRJM

Partnerët e projektit diskutuan rreth mënyrës së qasjes ndaj aktiviteteve për vitin 2019(trajnimet e mësimdhënësve dhe vullnetarëve, seminarët nacional, aktivitetet vullnetare) dhe për atë se si duhet strukturuar e-platforma. Një fokus i veçantë u vendos mbi mënyrën e përmirësimit të shpërndajes së informatave, mbi metodologjinë e vlerësimit si dhe mbi vizibilitetin e projektit. Dita e dytë e takimit iu kushtua vizitave të shkollave të Shkupit- shkollës "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid" si dhe Qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve me popullsi dominante rome. Në takim ishte pjesëmarrës edhe përfaqësuesi i EACEA-s.

Takimi i ardhëshëm: Regensburg, Gjermani, 20 deri 22 Maj 2019.

Janë përpiluar rekomandime të përbashkëta politike në nivel local, rajonal dhe europian, në përputhje me rekomandimet e KE-së

Projekti ka zhvilluar një studim gjithpërfshirës të arsimimit të romëve dhe migrantëve në vendet partner. Studimi fillestar-raporti përmbledhës është i qasshëm nëhttps://romigsc.eu/resources/. Përveç aspekteve tjera, studimi përfshin rekomandime politike në nivele të ndryshme:

Rekomandime në nivel lokal

- Të ndiqet një qasje që përfshin më shumëpjesëmarës dhe më shumë agjenci.
- Të zhvillohet një plan integrues në nivel komunal.
- Të mbështeten shkollat, të sigurohen burime shtesë, të planifikuar dhe të paparashikuar.
- Të mbështeten vullnetarët dhe të inkurajohet shoqëria civile.
- Tërrjetëzohen pjesëmarrësit e ndryshëm(mësimdhënësit, të punësuarit në administratë, punëtorët social- këshilltarët dhe vullnetarët) që të mësojnë nga njëri tjetri.
- Të mbështetet dhe financohet puna sociale në shkollë.

Rekomandime në nivel rajonal

- Të gjitha politikat duhet të adresojnë situatën e përgjithshme sociale dhe mundësitë shoqërore.
- Politikat arsimore të bazohen në të kuptuarin e mjaftueshëm kompleks të fakteve të një shoqërie migruese.
- Të sigurohen resurse të përshtatshme që do të synojnë njësituatëmë të ndërlikuar.
- Të nxitet ekperimentimi dhe fleksibiliteti për t'u ballafaquar me probleme të reja, të përshtaten dhe jepen zgjidhje nga poshtë-lartë.
- Të investohet në arsimimin e mësuesve dhe në shkëmbimin ndërkombëtar, të nxitet perspektiva ndërkombëtare si par-akusht për mësimdhënie me kompetencë.
- Të definohen si duhet kërkesat për kompetencat e mësid-hënësve, të theksohet komunikimi, empatia, inteligjenca emocionale, përshtatshmëria.
- Të zgjerohet përdorimi i mediave digjitale në shkollë me qëllim që të mundësohet dallimi, të financohet dhe të nxitet zhvillimi i mediave digjitale adekuate dhe kompetencave kritike të mediave.

Rekomandime në nivel të be-së

- Të përforcohen përpjekjet për "europianizim" të arsimit: ar-simi duhet të përgaditet për situata të ndryshme të migirimit të shkurtër, të mesëm dhe afatgjatë.
- Të mbështetet arsimi shkollor i cili përgaditet për migrimin jo vetëm në drejtim të përforcimit të kompetencave ndërkul-turore dhe hapjes ndaj diversitetit, por gjithashtu edhe duke i nxitur kompetencat dhe përmbajtjet mësimore të cilat janë të dobishme në situata ndërkombëtare dhe në më shumë shtete.

Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

https://romigsc.eu

Përfshirja e romëve dhe emigrantëve nëpër shkolla

Trajnime, diskutime të hapura dhe aktivitete rinore vullnetare

Aktivitete vullnetare

- **Kur:** Nga shkurti gjer në korrik 2019
- **Ku:** IRJM (shkup dhe Tetovë), Itali (Provincat e Tarantos dhe Barit), Slloveni (Celje dhe rajone tjera), Spanjë (province e Alikantes)
- **Si**: 2-4 vullnetarët do të bëjnë përafërsisht 120 orë(përgaditje dhe implementim i aktiviteteve) vullnetari në shkolla të përzgjedhura.Ata do t'i ndihmojnë nxënësit t'i përmirësojnë dijet gjuhësore, do t'i ndihmojnë në organizimin e aktiviteteve (sportive, kulturore,...) të cilat e mbështesin shkollën dhe përfshirjen sociale. Një mentor nga shkolla do t'i mbështesë vullnetarët.
- **Qëllimi i përgjithshëm i vullnetarisë:** (a) t'i ndihmojë fëmijët emigrant/romë drejt integrimit më të mirë në shkolla dhe në shoqëri; (b) t'i ndihmojë vullnetarët e rinj të ndjehen më të kyçur në shoqëri, të jenë më të angazhuar si qytetar, të fitojnë përvoja të cilat do t'i rrisin mundësitë e tyre për punësim.

Ne i ftojmë:

- Të gjithë vullnetarët/ sidomos vullnetarët e rinj/ studentët(e moshës 18-30)
- Shkollat më fëmijë rome/ migrant si institucione nikoqire për vullnetarët

T'i bashkëngjiten projektit dhe të punojnë sëbashku në projektet shkollore(aktivitetet) të cilat kanë për qëllim ta mbështesin integrimin dhe kyçjen sociale të këtyre grupeve të lëndueshëm.

Ftesa për vullnetarë dhe shkolla nikoqire (sipas vendeve) janë të publikuar në linkun https://romigsc.eu/events/.

Trajnime për vullnetarë (1 ditë dhe onlajn)

- IRJM, Shkup, 11 shkurt 2019
- Itali, Taranto, 12 shkurt 2019
- Sllovenia, Celje, 7 shkurt 2019
- Spanjë, Alikante, 15 shkurt 2019

Pjesëmarrësit/ studentët të cilët do ta bëjnë trajnimin dhe të cilët do të marrin pjesë në aktivitetet vullnetare, do të fitojnë 6 ECTS kredi- në nivelin deridiplomik, çertifikatë të lëshuar nga ISSBS- lënda me titull: Përgjegjësia shoqërore dhe vullnetaria.

Trajnime për mësimdhënësit (2 ditë)

- IRJM, Shkup, 4–5 prill 2019
- Itali, Taranto, 19 shtator 2019 dhe Bari, 20 shtator 2019
- Slloveni, Lubjanë, 5 qershor 2019
- Slloveni, Murska Sobota, 6 qershor 2019
- Spanjë, Orihuela 13 qershor 2019 dhe Valensi, 11 korrik 2019

Seminar nacional (1 ditë)

- IRJM, Shkup, 4 prill 2019
- Itali, Taranto, 18 shtator 2019
- Slloveni, Lubjanë, 5 qershor 2019
- Spanjë, Valensi, 11 korrik 2019
- Turqi, Stamboll, 28 shtator 2019

Seminar për organizatat shoqërore, OJQ-të

- Gjermani, Regensburg, 22 maj 2019
- Turqi, Stamboll, 18 qershor 2019

Seminar për drejtorët, kujdestarët e klasave, mësimdhënësit

- Gjermani, Regensburg, 22 maj 2019
- Turqi, Stamboll, 28 shtator 2019

Konferencë ndërkombëtare

- Slloveni, Lubjanë, 10 tetor 2019

Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Erasmus+, VK3: Iniciativa për politikë inovative – Përfshirja sociale përmes arsimit, trajnimit dhe rinisë
Numri i projektit: 580228-EPP-1-2016-1-SI-EPPKA3-IPI-SOC-IN
Projekt tre vjeçar: 31 dhjetor 2016–31 dhjetor 2019
Shtetet pjesëmarrëse në projekt: Sllovenia, Gjermania, Spanja, Italia, IRJ e Maqedonisë, Turqia

Mbështetja e Komisionit Evropian për këtë botim nuk nënkupton pajtim edhe me përmbajtjen, e cila pasqyron vetëm mendimet e autorëve. Komisioni nuk është përgjegjës për çfarëdo përdorimi të informacionit që gjendet këtu.